



UNMIK/REG/2005/24
9 maj 2005

RREGULLORE NR. 2005/24

MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR MIRËQENIEN E KAFSHËVE TË MIRATUAR
NGA KUVENDI I KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh komunikatën e lëshuar nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës më 13 prill 2005 lidhur me Ligjin mbi mirëqenien e kafshëve, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 23 mars 2005,

Duke vënë re se dispozitat e Ligjit nuk i cenojnë kompetencat e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo kompetencat dhe përgjegjësitë e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin mbi mirëqenien e kafshëve të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 02/L-10), që i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje, i cili bëhet i plotfuqishëm në ditën e nënshkrimit, me kusht që shprehja “Masat ndëshkuese” në titullin e Kreut VI fshihet dhe të zëvendësohet me shprehjen “Sanksionet administrative”, ndërsa fjala “i dënuar” në nenin 17 të fshihet dhe të zëvendësohet me fjalën “i gjobitur”. Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligji.

Nënshkruar sot, më 9 maj 2005

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm